

# “SURYA RENEWABLE ENERGY” SH.P.K

## AKT THEMELIMI I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “SURYA RENEWABLE ENERGY” SH.P.K

Me vullnetin tonë të lirë, të shprehur edhe me nënshkrimin e këtij akt-themelimi në cilësinë e ortakëve themelues, ne:

- A. **Z. YIGIT ARMAN**, i biri i Fahrettin Amir, shtetas shqiptar, lindur në Ankara/Turqi, më 07/02/1986, mbajtës i kartës së identitetit të Republikës së Shqipërisë me nr. 034301839 dhe numër personal I60207113A, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- B. **Znj. ALTINGUL ARMAN**, shtetase turke, e bija e Fahrettin Amir, lindur në Ankara/Turqi, më 26/03/1983, mbajtëse e pashaportës së Republikës së Turqisë me nr. U25111604, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- C. **Z. AYTUG GUMRUKÇU**, i biri i Seyit, shtetas turk, lindur në Samsun/Turqi, më 21/02/1988, mbajtës i pashaportës së Republikës së Turqisë me nr. U08563695, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- D. **Znj. AYBIKE NUR YILDIRIM**, e bija e Seyit, shtetase turke, lindur në Trabzon/Turqi, më 24/09/1993, mbajtëse e pashaportës së Republikës së Turqisë me nr. U25370152, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- E. **Z. ALTIN KODRA**, i biri i Medat, shtetas shqiptar, lindur në Dibër/Shqipëri, më 16/12/1973, mbajtës i kartës së identitetit të Republikës së Shqipërisë me nr. 034233149 dhe numër personal H31216130E, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

krijojmë sot më datë 08/09/2022 shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “SURYA RENEWABLE ENERGY” SH.P.K me akt themelimi si vijon:

Akt Themelimi i shoqërisë tregtare “SURYA RENEWABLE ENERGY” SH.P.K është i mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

### Neni 1

#### Forma dhe emri i shoqërisë

Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “SURYA RENEWABLE ENERGY” SH.P.K. Shoqëria do t'i nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do t'i nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

### Neni 2

#### Selia e Shoqërisë

Selia e shoqërisë “SURYA RENEWABLE ENERGY” SH.P.K do të jetë në adresën: Kompleksi i Vilave “Rolling Hills”, Vila Nr. 79, Njësia Administrative Petrelë, Mullet, Tiranë. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë sipas parashikimeve të Statutit.

**Neni 3**

**Objekti i Veprimtarisë**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat e mëposhtme:

- Konsulencë, projektim, financim, ndërtim, vënien në punë, shfrytëzim, administrim, mirëmbajtje të Centraleve dhe/ose Impianteve të cilat bëjnë të mundur prodhimin dhe shfrytëzimin e energjise së rinovueshme nga Uji, Dielli, Era dhe të tjera.
- Realizimi i impianteve Fotovoltaike dhe Eolike për gjenerimin e energjisë elektrike së bashku me të gjitha komponentët në lidhje me ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e tyre.
- Sigurimin, transmetimin, shpërndarjen, importimin, eksportimin dhe tregtimin me shumicë dhe/ose pakicë si brenda ashtu edhe jashtë vendit të energjisë elektrike.
- Aktivitete financimi, ndërtimi, shfrytëzimi, konsulencë, qiramarrje, qiradhënie, tregtimi, import – eksport të çdo lloj malli, produkti dhe shërbimi, së bashku me transaksionet përkatëse të tyre.
- Kryerja e çdo lloj aktiviteti tregtar, industrial, financiar dhe transaksion në lidhje me pasuri të luajtshme e të paluajtshme të cilat janë të nevojshme ose të përshtatshme për arritjen e objektivave të Shoqërisë.

Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve sipas kushteve për ndryshimin e Statutit.

**Neni 4**

**Kohëzgjatja e Shoqërisë**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat. Ajo mund shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfardo lloj shkak.

**Neni 5**

**Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë “SURYA RENEWABLE ENERGY” SHPK është i përbërë nga Kontributi në Para, vlera totale e të cilit është **100.00 (njëqind) lekë**. Numri i Pjesëve, Kuotat e Pjesëmarrjes Ortakëve dhe Vlerat e Kontributeve paraqiten si më poshtë:

**Ortaku themelues YIGIT ARMAN:**

- Numri i pjesëve : 1.00 (një)
- Kuota e pjesëmarrjes : 25.00 % (njëzetë e pesë përqind) kontribut në para
- Vlera e Kontributit : 25.00 (njëzetë e pesë) lekë

**Ortaku themelues ALTINGUL ARMAN:**

- Numri i pjesëve : 1.00 (një)
- Kuota e pjesëmarrjes : 20.00 % (njëzetë përqind) kontribut në para
- Vlera e Kontributit : 20.00 (njëzetë) lekë

**Ortaku themelues AYTUG GUMRUKÇU:**

- Numri i pjesëve : 1.00 (një)
- Kuota e pjesëmarrjes : 23.00 % (njëzetë e tre përqind) kontribut në para
- Vlera e Kontributit : 23.00 (njëzetë e tre) lekë

**Ortaku themelues AYBIKE NUR YILDIRIM:**

2



## “SURYA RENEWABLE ENERGY” SH.P.K

- Numri i pjesëve : 1.00 (një)
- Kuota e pjesëmarrjes : 22.00 % (njëzetë e dy përqind) kontribut në para
- Vlera e Kontributit : 22.00 (njëzetë e dy) lekë

### **Ortaku themelues ALTIN KODRA:**

- Numri i pjesëve : 1.00 (një)
- Kuota e pjesëmarrjes : 10.00 % (dhjetë përqind) kontribut në para
- Vlera e Kontributit : 10.00 (dhjetë) lekë

Pjesmarrja e ortakëve në Kapitalin e Shoqërisë është në mënyrë proporcionale, në përputhje me kontributin e tyre. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).


### **Neni 6**

#### **Drejtimi i Shoqërisë**

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, **Z. YIGIT ARMAN** atësia Fahrettin Amir, shtetas Shqiptar, lindur më 07/02/1986, në Ankara/Turqi, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i kartës së identitetit të Republikës së Shqipërisë me nr. 034301839 dhe numër personal I60207113A.

Administratori është përfaqësuesi i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj. Çdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme.

Specimenti i nënshkrimit:



### **Neni 7**

#### **Fitimi**

Fitimi do të ndahet në mënyrë proporcionale në bazë të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë..

### **Neni 8**


#### **Vendimet e Shoqërisë**

Vendimet kryesore të veprimtarisë së Shoqërisë merren me vendim të Asamblesë së Ortakëve, e cila është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë, që ka të drejtën të miratojë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e aktivitetit të saj.

### **Neni 9**

#### **Zgjidhja e konflikteve**

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptar, pranë Gjykatave kompetente të Republikës së Shqipërisë.



# “SURYA RENEWABLE ENERGY” SH.P.K

## Neni 10

### Vula e shoqërisë

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

## Neni 11

### Rregjistrimi i Shoqërisë


Për rregjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personi i autorizuar do të pajiset me Prokurë të Posaçme nga Ortakët e Shoqërisë.

*Akti i themelimit u përpilua në 3 (tre) kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente, ndërsa 1 (një) kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “SURYA RENEWABLE ENERGY” SH.P.K.*


Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqërisë.

### Ortakët e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “SURYA RENEWABLE ENERGY” SH.P.K

Z. YIGIT ARMAN



Znj. ALTINGUL ARMAN




Z. AYTUG GUMRUKÇU



Znj. AYBIKE NUR YILDIRIM



Z. ALTIN KODRA



Përkthben nga gjuha shqipe në gjuhën turke:

